



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:019189

Datë: 18.09.2020

Numri i dokumentit: 01124477

P.nr.1015/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, gjyqtari Ertan Sejfulla, me zyrtaren ligjore Jeta Asllani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M.B., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.19/2020 të datës 20.05.2020, për shkak të veprës penale Mos raportimi apo raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 16.09.2020, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Shenaj Berisha dhe i akuzuari M.B., të njëjtën ditë, me datë 16.09.2020, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: M.B., i lindur me *data e lindjes...*, në P., me vendbanim në rr.”...”, nr.47, ne P., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, i pandehuri M.B., edhe pse ka qenë i detyruar ta bëjë deklarin e pasurisë, të ardhurave, dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare, me rastin e marrjes së detyrës zyrtare U.D. Drejtor i departamentit ligjor në Agjencinë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë, nuk e ka deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor prej d.30.04.2019-30.05.2019, duke pasur parasysh se me vendimin e dt.30.04.2019, i është vazhduar mandati si U.D. Drejtor i departamentit ligjor në Agjencinë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë,-

- me këtë ka kryer veprën penale Mos raportimi apo raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.1 të KPRK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 38; 39; 40; 43; 69 dhe 430 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365, të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit: M.B., i shqipton dënim në gjobë në shumë prej **300.00 €** (treqind), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi do t'i llogaritet me 20.00 € gjobë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej **tridhjetë (30.00) €**, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumë prej **tridhjetë (30.00) €**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

ARSYETIMI

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.19/2020 të datës 20.05.2020, ndaj të pandehurit M.B., për shkak të veprës penale Mos raportimi apo raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.1 të KPRK-së,

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 16.09.2020, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit i është dhënë fjala që të deklarohet lidhur me fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke shtuar se fillimisht i vjen keq që ka ardhur në një situatë të tillë. Ndër të tjera deklaroi se është deklarues i rregullt i pasurisë konform ligjit për AKK dhe vonesa në deklarim assesi nuk duhet të nënkuptojë mungesën e vullnetit për të deklaruar pasurinë. I premton gjykatës që nuk do të përsëritet kjo vepër penale.

Pasi që i pandehuri M.B., e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, Gjykata merr mendimin e prokurorit të shtetit, i cili deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë sepse ky pranim fajësie ka mbështetje në shkresat e lëndës, si dhe bazë ligjore në bazë të nenit 248 të KPPK-së. Andaj i propozojë gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ta vlerësojë si rrethane lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ky pranim i fajësisë është bërë konform dispozitave të KPPK-së dhe si dhe në përputhshmëri me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Andaj i propozon gjykatës, që pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ta vlerësojë si rrethane lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Mos raportimi apo raportim i rreme pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.1 të KPRK-së.

Gjykata vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit; premtimin se nuk do të përsërisë vepra të tilla, faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, e që konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK-së.

Vendimi lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 05/L036).

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 18.09.2020.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr 1015/20, me datë 18.09.2020

Zyrtarja ligjore,
Jeta Asllani

Gjyqtari,
Ertan Sejfulla

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.